



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:003122
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05642223

Kom.Dh.Shk.II.nr.27/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbartimore të kreditori “New Line” sh.p.k, me nr. të biznesit 71246353, me seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani”, me pronar F.B, kundër debitorit Komuna e Prishtinës që sipas autorizimit përfaqësohet nga D.Gj, zyrtar ligjor tek debitori, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.825/22 të datës 30.10.2023, me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitori Komuna e Prishtinës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.825/22 të datës 30.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.825/22 të datës 30.10.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që e ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 159/19 i datës 30.07.2019, i lejuar nga Përmbartues Privat Ilmi Miftaraj sa i përket borxhit në lartësi prej 189.55€. Ndërsa në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 159/19 i datës 30.07.2019, i lejuar nga Përmbartues Privat Ilmi Miftaraj, sa i përket borxhit në lartësi prej 1,735.28€.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Komuna e Prishtinës, për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe zbatimit të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e debitorit të aprovohet në tërësi si të bazuar dhe aktvendimin e atakuar KPPP.nr.825/22 të datës 30.10.2023 ta ndryshojë dhe ta refuzojë si të pabazuar propozimin e kreditorit.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitori është e pabazuar.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 30.07.2019 ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 641/20 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve Fatura nr. 07/2017 e datës 16.02.2017; Fatura nr. 08/2017 e datës 16.02.2017; Fatura nr. KKP017-3/18 e datës 13.12.2018; Fatura -001/2-18 e datës 25.10.2018; Fatura nr. KKP-017-2/18e datës 09.11.2018; Fatura nr. KKP-019-4/19 e datës 18.02.2019; Fatura nr. KKP-022-5/19 e datës 08.03.2019; Fatura nr. FB0001/19 e datës 23.01.2019; Fatura nr. FB0002/19 e datës 23.01.2019; Fatura nr. 103/19 e datës 12.02.2019; Fatura nr. FB0004/19 e datës 12.02.2019; Fatura nr. FB0005/19 e datës 06.03.2019; Fatura nr. FB0006/19 e datës 06.03.2019 dhe Fatura nr. KKP-F005/19 e datës 02.05.2019, ashtu që është detyruar debitori, që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekura, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,924.83 Euro me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të propozimit për përmbartim deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit, me arsyetimin se faturat e prezantuara nga kreditori janë në kopje dhe nuk janë në origjinal apo kopje të vërtetuara, dhe se të njëjtat nuk janë pranuar nga personat e autorizuar të palës debitorë. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të aprovohet ndërsa urdhrin për lejimin e përmbartimit të shfuqizohet.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim duke theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në ligj dhe ka të vetmin qëllim shtyrjen e përmbartimit respektivisht pagesës së borxhit, kjo pasi që debitori i ka pranuar faturat së bashku me mallin e porositur nga debitori. Andaj ka kërkuar që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.825/22 të datës 30.10.2023 në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që e ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 159/19 i datës 30.07.2019, i lejuar nga Përmbartues Privat Ilmi Miftaraj sa i përket borxhit në lartësi prej 189.55€. Ndërsa në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 159/19 i datës 30.07.2019, i lejuar nga Përmbartues Privat Ilmi Miftaraj, sa i përket borxhit në lartësi prej 1,735.28€. Duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit sa i përket borxhit në lartësinë e shumës prej

189.55€, si dhe kur e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit për lartësinë e borxhit në shumën prej 1,735.28€, me arsyetimin se me dispozitën e nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se e faturat nr. 07/2017 e datës 16.02.2017; Fatura nr. 08/2017 e datës 16.02.2017 nuk plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme në kuptim të nenit 29, par.3 të LPP-së, ngase të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e pranimit të shkresave të debitorit si institucion publik, por vetëm mbajnë një mbishkrim *“S.Bersiha”* e rrjedhimisht të njëjtat rezultojnë të mos jenë pranuar asnjëherë nga debitori. Po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori edhe përgjatë seancës dëgjimore nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme i ka dorëzuar debitorit faturat e lartcekura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, ashtu që debitori të jetë njoftuar detyrimin që buron nga fatura.

Mbi këtë bazë, gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi, duke anuluar urdhrin për lejimin e përmbarimit në vlerë prej 189.55 € shumë kjo që buron nga faturat e 4 lartcekura, pasi që të njëjtat, duke mos përmbajtur nënshkrimin e debitorit rezultojnë të jetë lëshuar njëanshëm nga kreditori.

Po ashtu, Kjo gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejta ka vendosur edhe në piken II të dispozitivit të aktvendimit, kur e lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor për borxhin në vlerë totale prej 1,735.28 EUR, pasi që faturat nr. KKP-017-3/18 e datës 13.12.2018; nr. -001/2-18 e datës 25.10.2018; nr. KKP-017-2/18 e datës 09.11.2018; nr. KKP-019-4/19 e datës 18.02.2019; nr. KKP-022-5/19 e datës 08.03.2019; nr. FB0001/19 e datës 23.01.2019; nr. FB0002/19 e datës 23.01.2019; nr. 103/19 e datës 12.02.2019; nr. FB0004/19 e datës 12.02.2019; nr. FB0005/19 e datës 06.03.2019; nr. FB0006/19 e datës 06.03.2019 dhe Fatura nr. KKP-F005/19 e datës 02.05.2019, i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme dhe rezultojnë të jenë të përshtatshme për përmbarim ngase i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara nga neni 29, par.3 të LPP-së, dhe se secila prej tyre është pranuar me rregull nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e protokollit të debitorit të vënë në këto fatura, sepse në këtë rast faturat e lartcekura burojnë nga raporti juridik kontraktual i krijuar mes kreditorit dhe debitorit sipas kontratës publike kornizë me nr. të prokurimit 616 18 006 111 e datës 29.05.2018 dhe se shërbimi në emër të të cilit janë lëshuar faturat përputhet me objektin e kontratës së lidhur mes palëve ndërgjyqëse, dhe i plotëson kushtet sipas dispozitave të LPP-së.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’ rast procedura sipas prapësimin i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Kjo Gjykate , i vlerësoi edhe pretendimet e palës debitorë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara, për arsye se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhrin përmbarimor janë dorëzuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa të njëjtat mbajnë vulën e pranimit dhe nënshkrimin e debitorit. Ndërsa fatura si në piken I të dispozitivit nuk i plotësojnë kushtet sipas LPP-së për tu konsideruar nga gjykata si dokumente të besueshme.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitori nuk ka ofruar provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit lidhur me propozimin për përmbarim të lëshuar nga përmbaruesi privat.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.27/24 dt. 30.04.2024

Gjyqtar,
Dren Rogova